

**UDHËZIM**  
**Nr. 5630, datë 21.11.2016**

**PËR KRITERET E LICENCIMIT PËR TË KRYER KONTROLLIN DHE PROVËN E  
MJETEVE ME MOTOR DHE TË RIMORKIOVE TË TYRE, KUR JANË BËRË NJË A MË  
SHUMË NDRYSHIME TË KARAKTERISTIKAVE KONSTRUKTIVE OSE  
FUNKSIONALE APO TË SISTEMEVE TË PAJISJEVE**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, neni 77, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikave 1 dhe 2, neni 232, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZON:

KREU I

Qëllimi i udhëzimit

1.1 Të përcaktojë kriteret që duhet të plotësojë subjekti juridik për t’u licencuar në veprimtarinë e kontrollit dhe të provës së mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve.

1.2 Të përcaktojë procedurat dhe dokumentacionin për veprimtarinë e kontrollit dhe të provës së mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve.

1.3 Të garantohet qarkullimi rrugor, ndotja atmosferike dhe akustike minimale, nga mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve.

KREU II

2. Fusha e zbatimit të udhëzimit

2.1 Ky udhëzim do të zbatohet për të gjithë mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteris-tikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve, të cilat janë të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe pronarët e tyre kërkojnë ndryshime të të dhënave në Regjistrin kombëtar të mjeteve dhe në lejen e qarkullimit të mjetit.

2.2 Ky udhëzim nuk do të zbatohet për mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, të cilat i përkasin ose janë nën përgjegjësinë e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë.

KREU III

3. Përkufizime

3.1 Për qëllime të këtij udhëzimi do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

“Ministri” nënkupton ministrin përgjegjës për transportin;

“Ministria” nënkupton ministrinë përgjegjëse për transportin;

“Kontroll dhe provë” nënkupton veprim-tarinë e kontrollit dhe të provës së mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve;

“Licencë” nënkupton licencën e lëshuar nga ministri përgjegjës për transportin subjektit juridik të licencuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për të kryer veprimtarinë e kontrollit dhe të provës së mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve;

“Subjekt i licencuar” nënkupton subjektin juridik të licencuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për autoriparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove dhe që disponon një licencë nga ministri përgjegjës për transportin, për të kryer veprimtarinë e kontrollit dhe të provës së mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve;

“Përgjegjës teknik” nënkupton inxhinierin e pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për riparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove dhe të emëruar nga subjekti si përgjegjës teknik, i cili drejton dhe mbikëqyrë të gjitha

operacionet e kontrollit dhe të provës së mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve, për të garantuar cilësi të lartë dhe zbatim rigoroz të legjislacionit përkatës;

“Komision Teknik” nënkupton grupin e specialistëve të pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për riparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove dhe të emëruar nga subjekti i licencuar si anëtar komisioni, të cilët nën drejtimin e përgjegjësit teknik, kryejnë kontrollin dhe provën e mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve, dhe në përfundim të kontrollit dhe provës hartojnë proces verbalin me rezultatet përkatëse;

“Certifikatë miratimi” nënkupton certifikatën e miratimit të ndryshimeve konstruktive në mjetet me motor dhe rimorkiot e tyre, lëshuar nga subjekti i licencuar, pas kontrollit dhe provës me rezultat pozitiv, të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve;

“DPSHTRR” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

“QKB” nënkupton Qendrën Kombëtare të Biznesit;

“Pronar i mjetit” nënkupton personin/ subjektin në emër të të cilit mjeti është i regjistruar në DPSHTRR;

“Mjet i ndryshuar” nënkupton çdo mjet me motor ose rimorkiot e tyre tek i cili janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve;

“Kodi Rrugor” nënkupton ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

“Rregullore e zbatimit të Kodit Rrugor” nënkupton vendimin e Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

“DAP” nënkupton dëshminë e aftësisë profesionale për riparimin e mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, lëshuar nga DPSHTRR-ja për përgjegjësit teknikë dhe teknikët, pas trajnimit dhe testimit në DPSHTRR.

#### KREU IV

##### 4. Licencimi i subjektit

4.1 Ministri licencon subjektet për kryer kontroll dhe provë, në zbatim të pikës 2, neni 77 të Kodit Rrugor dhe pikave 1 dhe 2, neni 232, të Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor.

4.2 Ministri licencon subjektet juridike për kontroll dhe provë, që plotësojnë të gjithë kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

4.3 Modeli i licencës është sipas aneksit 2, pjesë e këtij udhëzimi.

4.4 Numri i licencës është sipas aneksit 3, pjesë e këtij udhëzimi.

4.5 Licenca jepet me afat 1 (një) vit kalendarik, duke filluar nga data e lëshimit të saj.

#### KREU V

##### 5. Aplikimi për licencë

Subjekti juridik për të marrë licencë, duhet të paraqesë në Ministri:

5.1 Kërkesën për licencë, sipas modelit të aneksit 1, pjesë e këtij udhëzimi, në të cilën përcaktohen emri i subjektit, emri i drejtuesit ligjor, emri i përgjegjësit teknik, zërat që kërkohen për licencim në veprimtaritë me kodin VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” etj.

5.2 Ekstrakti dhe ekstrakti historik i regjistrit tregtar, nga QKB-ja.

5.3 Licencën nga QKB-ja për veprimtaritë me kodin VII.3.B.1, autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

5.4 Dëshmi penaliteti, për drejtuesin ligjor dhe për përgjegjës të teknik.

5.5 Kopje të noterizuar: të diplomës (inxhinier mekanik) të përgjegjës të teknik, të stafit teknik etj.

5.6 Kopje e dëshmisë së aftësisë të përgjegjës të teknik, të stafit teknik etj.

5.7 Kontratë me afat jo më pak se 1 (një) vit, ndërmjet drejtuesit ligjor me përgjegjës të teknik, si dhe me stafin teknik.

5.8 Vetdeklarim nga përgjegjësi teknik, sipas modelit të aneksit 5, pjesë e këtij udhëzimi, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e legjislacionit dhe të rregullave në fuqi, për gjendjen e makinerive, pajisjeve, bankoprovave etj., të nevojshme për veprimtarinë që kërkohet të licencohet, për dërgimin e informacionit periodik nga shoqëria etj.

5.9 Kërkesa për licencë plotësohet për herë të parë dhe për rinovim.

5.10 Dokumentet shoqëruese sipas këtij udhëzimi, për zërat përkatës në veprimtaritë me kodin VII.3.B.1, autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

5.11 Kërkesa për licencë duhet të paraqitet në emër të subjektit juridik dhe duhet të firmoset nga personi i autorizuar.

## KREU VI

### 6. Procedura e licencimit

6.1 Kërkesa dhe dokumentet e subjektit për t'u pajisur me licencë dërgohen me rrugë postare, për drejtorinë përkatëse në ministri. Pas kësaj, fillon procedura e verifikimit të dokumenteve dhe inspektimit në teren i subjektit, për plotësimin e të gjithë kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim.

6.2 Verifikimi i dokumenteve dhe inspektimi në teren i subjektit për plotësimin e kriterëve të përcaktuara, kryhet nga komisioni i ngritur me urdhër të ministrit.

6.3 Komisioni pasi kryen verifikimin e dokumenteve dhe inspektimin në terren të subjektit, harton proces verbalin mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim. Procesverbali së bashku me dokumentacionin i paraqet ministrit.

6.4 Komisioni refuzon kërkesën, kur subjekti ka mangësi në plotësimin e kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim. Subjektit i kthehet përgjigje me shkrim, duke evidentuar dhe mangësitë.

6.5 Licenca lëshohet nga ministri, kur janë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim dhe është paguar tarifa përkatëse prej 100 (njëqind) lekësh për llogari të Ministrisë.

6.6 Drejtoria përkatëse e Ministrisë duhet të mbajë të evidentuara të gjithë procedurat e miratimit, për çdo subjekt të licencuar.

6.7 Rinovimi i licencës do të bëhet kur subjekti ka operuar sipas kuadrit ligjor përkatës, vazhdon të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim dhe ka paguar tarifën përkatëse prej 100 (njëqind) lekësh për llogari të Ministrisë.

## KREU VII

### 7. Kriteret e subjektit për licencim

7.1 Të ketë eksperiencë dhe përvojë pune të suksesshme mbi 5 (pesë) vjet në riparimin/modifikimin/kontrolle dhe provë, të mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre.

7.2 Të ketë për përgjegjës teknik, inxhinier mekanik, me përvojë pune mbi 5 (pesë) vjet në riparim/modifikim/kontrolle dhe provë, të mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, me dëshmi/certifikatë nga DPSHTRR-ja apo nga vendet e BE-së, në mënyrë që të garantojë kontroll dhe provë me kompetencë dhe me cilësi, të mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre.

7.3 Të ketë jo më pak se 2 (dy) teknik, anëtarë të komisionit teknik, me përvojë pune mbi 5 (pesë) vjet në riparim/modifikim/kontrolle dhe provë, të mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, me dëshmi/certifikata nga DPSHTRR-ja apo nga vendet e BE-së, në mënyrë që të kryejnë kontroll dhe provë me kompetencë dhe me cilësi, të mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre.

7.4 Të ketë staf teknik, jo më pak se 2 (dy), me përvojë pune mbi 3 (tre) vjet në riparim/modifikim /kontrolle dhe provë, të mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, të cilët duhet të kenë përgatitjen e nevojshme profesionale.

7.5 Të ketë oficinë për të kryer kontroll dhe provë të mjetit të ndryshuar me kushte të mjaftueshme materialo-teknike e kapacitete operacionale, që të garantojnë funksionimin e përshtatshëm në ushtrimin e këtij shërbimi.

7.6 Të kenë në pronësi ose me qira:

- oficinë me sipërfaqe të brendshme jo më pak se 100 (njëqind) m<sup>2</sup> dhe me përmasa jo më pak se 5 x 20 m dhe të lartë 4.5 m;

- parkim me sipërfaqe jo më pak se 200 (dyqind) m<sup>2</sup> dhe me përmasa jo më pak se 10 x 20 m;

- zyra dhe ambiente shërbimi me sipërfaqe të brendshme jo më pak se 50 (pesëdhjetë) m<sup>2</sup>;

- pajisje kompjuterike së bashku me softuerët aplikativë nga fusha përkatëse e kontrollit dhe provës të mjeteve të ndryshuara.

- pajisjet e kontrollit, sipas aneksit 4, pjesë e këtij udhëzimi, të nevojshme dhe të domosdoshme për kontroll dhe provë të kërkesave dhe parametrave teknikë të mjeteve të ndryshuara, duhet të jenë sipas standardeve të BE-së.

7.7 Të sigurojë vazhdimisht paanshmëri profesionale në marrëdhëniet me grupet e interesit (personat fizik apo juridik) të cilët janë të varur në mënyrë direkte apo indirekte nga rezultati i kontrollit

dhe provës së mjeteve të ndryshuara.

7.8 Të ketë akreditimet/certifikimet në fushën e shërbimeve profesionale sipas standardeve ndërkombëtare “Për vlerësimin e konformitetit” ISO 17020 ose “Për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues” ISO 17025.

7.9 Të ketë certifikatën “Për menaxhimin e cilësisë” ISO 9001.

7.10 Të ketë kapacitetet e nevojshme për monitorimin e kontrollit dhe provës në kohë reale, përmes sistemeve të teknologjisë informative.

7.11 Të ketë nën vëzhgim me sistemin e elektronik të kamerave ofiçinën e kontrollit dhe provës, kryesisht ku kryhen ky shërbim.

7.12 Të jetë subjekt juridik i licencuar nga QKB-ja, për veprimtaritë me kodin VII.3.B.1, autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, për zërat që kërkon të licencohet.

7.13 Të jetë subjekt juridik i siguruar për përgjegjësinë në ushtrimin e veprimtarisë së kontrollit dhe provës.

7.14 Të vendosë në formën e garancisë bankare ose të shoqërisë së sigurimit, vlerën prej 10 000 (dhjetëmijë) eurosh për Ministrinë.

7.15 Të jenë të vendosura në vende me hyrje dhe dalje të autorizuar sipas legjislacionit, në rrugët e përdorimit publik, dhe ku lëvizja e mjeteve nuk do të krijojë probleme trafiku.

7.16 Të informojë rregullisht Ministrinë dhe DPSHTRR-në me shkrim, me anë të një raporti 3-mujor (tremujor), për gjendjen (funktionale, teknike, kapacitetin etj.) dhe sasinë e mjeteve të ndryshuar që kanë kryer kontroll dhe provë.

## KREU VIII

### 8. Regjistrat

8.1 DPSHTRR-ja mban një regjistër për subjektet e licencuara. Regjistri mund të mbahet dhe në formë elektronike dhe duhet të mbahet në ruajtje për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet.

8.2 Në regjistrin e subjekteve të licencuara, DPSHTRR-ja evidenton dhe këto të dhëna:

- emrin e plotë të subjektit të licencuar;
- NIPT-in e subjektit të licencuar;
- shenjën e veçantë të vulës së subjektit të licencuar;
- emrin e përgjegjësit teknik të subjektit të licencuar;
- emrat e teknikëve të pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale;
- adresën e plotë të subjektit të licencuar;
- datën e lëshimit dhe të përfundimit të licencës;
- tel, fax, e-mail etj., të subjektit të licencuar.

8.3 Numri i licencës së subjektit të licencuar, duhet të jetë në vulën e subjektit.

8.4 Subjekti i licencuar duhet të mbajë një regjistër, në të cilin të regjistrohen të gjithë operacionet e kryera të kontrollit dhe provës. Regjistri mund të mbahet dhe në formë elektronike dhe duhet të mbahet në ruajtje për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet.

8.5 Në regjistrin e kontrollit dhe provës, subjekti i licencuar evidenton dhe këto të dhëna të mjetit të ndryshuar:

- të dhënat e përgjithshme;
- të dhënat e pronarit;
- ndryshimet e kryera;
- të dhënat e subjektit që ka kryer ndryshimet;
- dokumentacionin e lëshuar nga subjekti që ka kryer ndryshimet;
- të dhënat e kontrollit dhe provës;
- kopje e certifikatës së miratimit.

8.6 Subjekti i licencuar duhet të garantojë mbajtjen e të dhënave të kontrollit dhe provës, si dhe transferimin e tyre pranë DPSHTRR-së.

8.7 Regjistrat me të dhënat sipas këtij udhëzimi, duhet të plotësohen dhe të mbahen të rregullt dhe pa korrigjime. Regjistrat do të jenë objekt i kontrollit nga Ministria dhe DPSHTRR-ja.

## KREU IX

### 9. Pajisjet e kontrollit dhe provës

9.1 Pajisjet për kontroll dhe provë duhet të jenë sipas zërave përkatës në veprimtaritë me kodin VII.3.B.1, autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, për të garantuar cilësinë e të gjithë

operacioneve respektiv të kontrollit dhe provës. Pajisjet duhet të jenë të standardeve të BE-së, të kalibruar nga prodhuesi ose i autorizuari i prodhuesit, dhe me certifikatë.

9.2 Subjekti i licencuar duhet të ketë gjithnjë në gatishmeri të plotë pajisjet e nevojshme për kryerjen me cilësi të kontrollit dhe provës.

9.3 Pajisjet për kontroll dhe provë duhet të jenë në çdo kohë të mirëmbajtura dhe me shërbime të kryera, për të garantuar përdorimin e tyre në përputhje me standardet dhe cilësinë e kërkuar për kontroll dhe provë. Pajisjet dhe mirëmbajtja e tyre do të jenë objekt i kontrollit nga Ministria dhe DPSHTRR-ja.

## KREU X

### 10. Procedura e kontrollit dhe provës

10.1 Pronari i mjetit ose i autorizuari i tij, bën kërkesë për të kryer kontroll dhe provë, së cilës i bashkëngjiten:

- dokumentacionin e mjetit të ndryshuar (të dhënat teknike nga prodhuesi/certifikata e përputhshmërisë COC/leja e qarkullimit etj.);

- të dhënat e subjektit që ka kryer ndryshimet në mjetin rrugor;

- dokumentacionin e lëshuar nga subjektit që ka kryer ndryshimet në mjetin rrugor;

10.2 Kur kërkesa dhe dokumentacioni janë sipas legjislacionit, subjekti i licencuar cakton ditën e paraqitjes së mjetit të ndryshuar për kontroll dhe provë.

10.3 Subjekti i licencuar do të kryej kontroll dhe provë, për të garantuar sigurinë e qarkullimit të mjetit të ndryshuar, përpara ndryshimeve në regjistrin e mjeteve në DPSHTRR dhe në lejen e qarkullimit të mjetit rrugor.

10.4 Kontrolli dhe prova në përgjithësi ka të bëjë me:

- kontrollin identifikues të mjetit rrugor;

- kontroll dhe provë të mjetit të ndryshuar;

- lëshimin e certifikatës së miratimit.

10.5 Kontrolli dhe prova ka të bëjë dhe me procedurën e kontrollit të plotësimit të kërkesave teknike që garantojnë siguri në qarkullim, mbrojtje të shëndetit të njerëzve e të mjedisit, si dhe kërkesat e tjera të ndërlydhura me këto mjete, rimorkio apo sisteme të tyre.

10.6 Plotësimi i kërkesave teknike konsiderohet në harmoni të plotë, kur nga kontrolli dhe prova rezulton përputhshmëri me të gjitha kërkesat e përcaktuara teknike të rregulloreve respektive kombëtare dhe ndërkombëtare.

10.7 Pas kontrollit dhe provës, kur plotësohen kërkesat teknike, subjekti i licencuar, plotëson dokumentacionin e nevojshëm dhe proces verbalin, sipas modelit të miratuar nga DPSHTRR-ja. Gjithashtu, lëshon certifikatën e miratimit, sipas modelit të miratuar nga DPSHTRR-ja.

10.8 Pas kontrollit dhe provës, kur nuk plotësohen kërkesat teknike, subjekti i licencuar njofton pronarin e mjetit ose të autorizuarin i tij dhe nuk lëshon certifikatën e miratimit.

10.9 DPSHTRR-ja nuk do të kryej asnjë ndryshim në regjistrin e mjeteve rrugore dhe në lejen e qarkullimit të mjetit rrugor, kur mjeti i ndryshuar nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, nuk ka certifikatën e miratimit dhe proces verbalin e Komisionit Teknik.

10.10 Subjekti i licencuar duhet të zbatojë legjislacionin në fuqi, konkretisht Kodin Rrugor, rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor dhe këtë udhëzim, përpara lëshimit të certifikatës së miratimit.

10.11 Përgjegjësi teknik duhet të drejtojë dhe të mbikëqyrë të gjithë operacionet e kontrollit dhe provës, për të garantuar cilësi të lartë të tyre dhe zbatimin e legjislacionit përkatës.

10.12 Kontrolli dhe prova bëhet nga Komisioni Teknik dhe nën drejtimin e përgjegjësit teknik, i cili është dhe kryetar komisioni. Komisioni Teknik duhet të ketë dhe jo më pak se 2 anëtarë, teknikë me dëshmi aftësie.

10.13 Komisioni Teknik do të kryej kontrollin dhe provën, vetëm kur ndryshimet konstruktive të kërkuara janë sipas legjislacionit në fuqi. Kontrolli dhe prova duhet të kryhen me cilësi të lartë dhe në përfundim, Komisioni Teknik harton proces verbalin, i cili miraton ose refuzon kërkesën e pronarit të mjetit ose të autorizuarit të tij.

10.14 Certifikata e miratimit do të lëshohet kur Komisioni Teknik ka dhënë miratimin në proces verbal. certifikata e miratimit duhet të shoqërohet dhe me proces verbalin e Komisionit Teknik.

10.15 Përgjegjësi teknik do të jetë pika e kontaktit për subjektin e licencuar me autoritetet që do të ushtrojnë kontroll të operacioneve teknike. Ai do të jetë përgjegjës për cilësinë dhe ligjshmërinë e operacioneve të kryera të kontrollit dhe provës nga subjekti i licencuar.

## KREU XI

### 11. Kontrolli i subjekteve të licencuara

11.1 Ministria dhe DPSHTRR-ja, ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në subjektet e licencuara, për të ruajtur standardet e cilësisë së kontrollit dhe provës, për plotësimin legjislationit dhe kritereve të këtij udhëzimi.

11.2 Subjektet e licencuara janë të detyruara të lejojnë kontrollorët e Ministrisë dhe DPSHTRR-së, të inspektojnë gjatë kohës që ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Inspektimi do të kryhet nga kontrollorët jo më pak se një herë në vit, gjatë të cilit subjekti i licencuar duhet të krijojë lehtësira për kontroll.

11.3 Regjistri i operacioneve teknike, raportet e kontrollit dhe provës etj., duhet të jenë në dispozicion të kontrollorëve gjatë orarit të punës.

11.4 Monitorimi i subjekteve të licencuara duhet të trajtohet nga DPSHTRR-ja gjithmonë si një aktivitet i vazhdueshëm.

11.5 Mirëmbajtja dhe plotësimi i gjithë dokumentacionit nga subjekti i licencuar, do të jenë objekt kontrolli i Ministrisë dhe DPSHTRR-së.

## KREU XII

### 12. Masat disiplinore

12.1 Licenca mund të pezullohet ose të tërhiqet nga ministri në rast se subjekti i licencuar:

- nuk plotëson kriteret për të cilat ka marrë licencën;
- nuk kryen me cilësi kontrollin dhe provën dhe procedurat administrative, të cilat janë me shkelje dhe nën një nivel të pranueshëm;
- kryen praktika të aktiviteteve të paligjshme dhe kriminale, të cilat dhe janë konstatuar;
- ka paraqitur deklaratime të pavërteta, informacione jo të saktë ose të falsifikuar, në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës, të cilat dhe provohen;
- ka operuar në mënyrë të tillë që ka shkaktuar humbjen e respektit me kontrole dhe prova jokorrekte për marrjen e certifikatës së miratimit;
- nuk ka mbajtur në rregull regjistrat dhe dokumentacionin sipas këtij udhëzimi.

12.2 Kur subjekti i licencuar nuk plotëson më kriteret e miratimit, ministri do të vendosë për masën disiplinore që do të marrë ndaj tij.

12.3 Kur janë konstatuar shkelje apo mangësi të vogla gjatë operacioneve të kontrollit dhe provës nga subjekti i licencuar, masa disiplinore do të konsistojë me këshillim, ndërsa në raste serioze si në pikën 12.1., do të ketë masë disiplinore me pezullim ose tërheqje të licencës.

12.4 Në rastet kur bëhet pezullimi apo tërheqja e licencës, Ministria duhet të njoftojë subjektin e licencuar dhe DPSHTRR-në, duke përcaktuar dhe periudhën në rastet e pezullimit.

12.5 Për masën disiplinore të marrë nga ministri, subjekti i licencuar mund të ankimojë sipas ligjit “Kodi i Procedurave Administrative”.

## KREU XIII

### 13. Dispozita kalimtare

13.1 Deri në datën 30.6.2017, për licencimin e parë të subjekteve për kontroll dhe provë, kur për arsye objektive subjekti nuk ka të plotë gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë udhëzim, si p.sh.: akreditimet/certifikimet e subjektit etj., Komisioni mund të propozojë te ministri për dhënien e licencës, duke përcaktuar dhe afatin kohor të dorëzimit të dokumentit që mungon.

## KREU XIV

### 14. Dispozitat e fundit

14.1 Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
**Sokol Dervishaj**



## ANEKSI 1

### MODELI I KËRKESËS PËR LICENCË

Plotësohet nga aplikanti, subjekti juridik (administraton).

1. Unë : \_\_\_\_\_  
Dëshiroj të aplikoj për licencim për kontroll dhe provë;  
Plotesohen dhe zërat në të cilat kërkon licencën.
2. Emri dhe adresa e aplikantit (subjektit):  
\_\_\_\_\_  
(Emri e aplikantit, Adresa e plotë, Telefon nr., Fax nr., E-mail adres, Etj)
3. Adresa e oficinës, e cila është propozuar për të kryer kontroll dhe provë  
(nëse është e ndryshme nga ajo e pikës 2 më sipër).  
\_\_\_\_\_  
(Adresa e plote, Telefon nr., Fax nr., E-mail adres)
4. Emri i përgjegjësit teknik, anëtarëve të komisionit teknik dhe stafit teknik  
\_\_\_\_\_
5. Orari i punës, në të cilën oficina do të jetë e hapur për kontroll dhe provë.  
E hënë deri të shtunën nga ora \_\_\_\_\_ deri në ora \_\_\_\_\_.
6. Pajisjet - përshkrim i plotë i të gjithë pajisjeve në dispozicion:  
\_\_\_\_\_
7. Të tjera .  
(Informacion dhe dokumenta shtesë sipas udhezimit dhe që i bashkëlidhen këtij aplikimi.)
8. Subjekti që do kryej riparimin, mirëmbajtjen dhe kalibrimin e pajisjeve  
\_\_\_\_\_  
(Emri i shoqërisë, Adresa, Telefon nr., Fax nr., E-mail adres, etj)
9. Dokumentet e mëposhtme mbështetëse:
  - a. Planimetri e vendndodhjes së subjektit aplikues
  - b. Planimetri e oficinës, me përmasa jo më pak se 5 x 20 x 4.5 m;
  - c. Planimetri e parkimit, përmasa jo më pak se 10 x 20 m;
  - d. Planimetri e zyrave dhe ambiente shërbimi jo më pak se 50 m<sup>2</sup>;
  - e. Dokumente për përdorimin e ndërtesës;
  - f. Certifikatat ISO 17020, ISO 17025 dhe ISO 9001;
  - g. Garanci bankare ose të shoqërisë së sigurimit, 10 000 Euro;
  - h. Ekstrakti i regjistrit tregtar, nga QKR;



- i. Ekstrakti Historik i regjistrit tregtar, nga QKR;
- j. Licencen nga QKB per nenkategorine VII.3.B.1;
- k. Dëshmi penaliteti për drejtuesin ligjor;
- l. Për Përgjegjësën Teknik:
  - Dëshmi penaliteti nga Prokuroria dhe Gjykata,
  - Kopje të noterizuar: të Diplomës (inxhinjer mekanik),
  - Kopje e Dëshmisë së aftësisë profesionale,
  - Kontratë me afat jo më pak se 1 (një) vit,
  - Vetdeklarim në lidhje me njohjen dhe zbatimin e legjislacionit,
  - Dokument për Përgjegjësën Teknik, përvojë pune mbi 5 (pesë) vjet;
- m. Për stafit teknik:
  - Kopje të noterizuar: të diplomave,
  - Kopje e Dëshmisë së aftësisë profesionale,
  - Kontratë me afat jo më pak se 1 (një) vit,
  - Dokument për 2 (dy) anëtar komisioni, përvojë mbi 5 (pesë) vjet,
  - Dokument për 2 (dy) teknik, përvojë pune mbi 3 (tre) vjet;
- n. Dokument për subjektin, përvojë pune mbi 5 (pesë) vjet;
- o. Dokumentin që subjekti është i siguarar për përgjegjësinë në ushtrimin e veprimtarisë së Kontrollit dhe Provës.

10. Deklarata dhe paraqitja

Unë deklaroj që informacioni i dhënë në këtë formular në lidhje me aplikimin për miratim është i vërtetë për njohuritë e mia më të mira.

Unë jam dakord për të zbatuar dhe plotësuar kushtet në udhëzimin e Ministrisë nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ “Për kriteret që duhet të plotësojë subjekti që të licencohet për kryerjen e kontrollit dhe provës së mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre, kur janë bërë ndryshime konstruktive”.

Emri Mbiemri

Firma e aplikantit

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Pozicioni

Për dhe në emër të subjektit

ANEKSI 2  
MODELI I LICENCËS



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARTEVE DHE MONITORIMIT  
DREJTORIA E QARKULLIMIT DHE SIGURISË RRUGORE

**L I C E N C Ë**

Nr. AL, KP \_\_\_/\_\_\_ datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

**PËR**

**KONTROLL DHE PROVË TË MJETEVE ME MOTOR DHE  
RIMORKIOVE TË TYRE, KUR JANË BËRË NJË A MË SHUMË  
NDRYSHIME TË KARAKTERISTIKAVE KONSTRUKTIVE OSE  
FUNKSIONALE APO TË SISTEMEVE TË PAJISJEVE**

Në mbështetje të pikës 2, neni 77 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 1 dhe 2, neni 232 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, lëshon këtë Licencë.

**I LËSHOHET:**

**Subjektit Juridik:** \_\_\_\_\_

**Administrator:** \_\_\_\_\_

**Me seli në:** \_\_\_\_\_

Licenca është e vlefshme deri më datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_.

(Emri Mbiemri)

**MINISTËR**

### ANEKSI 3

#### NUMRI I LICENCËS

Numri i Licencës, që do të shënohet dhe në vulën e Subjektit të Licencuar, do të ketë formën:

**AL, KP / XX/YY**

p.sh.: AL KP 01/02

**AL** – nënkupton Albania

**KP** – nënkupton Kontroll dhe Provë të mjeteve rrugore

**XX** – është numëri rendor vijues në regjistrin e licencave të Kontrollit dhe Provës dhe që nuk ndryshon për subjektin e licencuar edhe në rast rinovimi licence;

**YY** – është numri rendor vijues i rinovimit të licencës së Kontrollit dhe Provës dhe që ndryshon për subjektin e licencuar sa herë që rinovon licencën.

## ANEKSI 4

### PAJISJET E KËRKUARA

Oficina e kontrollit dhe provës, për të gjitha zërat në veprimtarinë me kodin VII.3.B.1, autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të ketë:

- Pajisje për kontrollin e gazrave të mjeteve rrugore me benzinë;
- Pajisje për kontrollin e gazrave të mjeteve rrugore me gazoil;
- Pajisje për matjen e nivelit të zhurmave të mjeteve rrugore;
- Pajisje për matjen e fokusit të fenerëve;
- Pajisje për matjen e devijimit të mjeteve rrugore;
- Pajisje për kontrollin e amortizatorëve të mjeteve rrugore;
- Pajisje për kontrollin e frenave të mjeteve rrugore (bankëprovë me rula);
- Pajisje për kontrollin e xhokove të mjeteve rrugore;
- Pajisje për kontrollin e rrjedhjeve të gazit në mjetet rrugore;
- Kompjuter për kontroll dhe funksionim e sistemeve të mjeteve rrugore;
- Kompresor;
- Manometër për kontrollin e presionit të gomave të mjeteve rrugore;
- Bombula zjarrëfikse;
- Kompjuter me sistem ruajtje për të transferuar të dhënat;
- Sistem, nëpërmjet e-mail-it apo të internetit, për të komunikuar dhe transmetuar me autoritetet kompetente, sipas kërkesës, të dhënat e grumbulluara.

**Shenim:** Oficina e kontrollit dhe provës, që do të jenë për zëra të veçantë në veprimtarinë me kodin VII.3.B.1, autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, duhet të ketë respektivisht pajisjet e nevojshme përkatëse.

## ANEKSI 5

### VETËDEKLARIM

Tiranë, më datë...../...../.....

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me dokument identifikimi Nr. \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se subjekti \_\_\_\_\_ me NIPT/NUIS \_\_\_\_\_ disponon pajisjet didaktike dhe mjediset e nevojshme, për të ushtruar aktivitetin për kontrollin dhe provën e mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve, sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Deklaroj se:**

*Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën, që kërkoj të ushtror aktivitetin, për kontrollin dhe provën e mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve.*

*Do të zbatoj të gjitha detyrimet, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për kontrollin dhe provën e mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve.*

*Të gjitha të dhënat e nënsipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

**Me respekt,**

---

**( Emër , Mbiemër, Firmë)**